



Kombëtaria e Kosovës  
Republika Kosovo • Republic of Kosovo  
Institucioni i Avokatit të Popullit  
Institucija Ombudsmana • Ombudsperson Institution

Nr./Br./No. 1567/2023  
Nr.i fai/Br./str./Nr.pg. 21109/2023  
Data/Datum/Date: 21/09/2023

PRISHTINË-PRIŠTINA-PRISTINA



Republika e Kosovës • Republika Kosovo • Republic of Kosovo  
Institucioni i Avokatit të Popullit • Institucija Ombudsmana • Ombudsperson Institution

**RAPORT  
I  
AVOKATIT TË POPULLIT**

**A. nr. 696/2021**

**Fadil Bajrami**

**lidhur me zvarritjen e procedurës gjyqësore për lëndën C.nr.2837/17 në Gjykatën  
Themelore në Prishtinë**

Për: Znj. Albina Shabani Rama, kryetare  
Gjykata Themelore në Prishtinë

Prishtinë, më 21 shtator 2023

## Qëllimi i reportit

1. Ky rapport bazohet në ankesën individuale që kemi pranuar nga z. Fadil Bajrami (në tekstin e mëtejëmë: ankuesi) dhe në dokumentacionin mbështetës që ka ofruar pala, përkitazi me zvarritjen e procedurës për ta shqyrtuar lëndën C.nr.2837/17.
2. Raporti ka për qëllim t’ia adresojë Gjykatës Themelore në Prishtinë (GjThP) konstatimet lidhur me cenimin e së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm kohor dhe adresimin e rekomandimeve lidhur me nevojën e ndërmarrjes së veprimeve procedurale për shqyrtimin e lëndës C.nr. 2837/17.

## Baza ligjore

3. Bazuar në nenin 135, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës:

*“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa, nëse vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga ana e organeve të administratës publike dhe organeve të tjera shtetërore.”*

4. Po ashtu Ligji nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, nen 16, paragrafi 8, përcakton:

*“Avokati i Popullit mund të jep rekomandime të përgjithshme përfunksionimin e sistemit gjyqësor. Avokati i Popullit nuk do të ndërhyjë në rastet dhe në procedura tjera ligjore që janë duke u zhvilluar para gjykatave, përvèç rastit kur ka zvarritje të procedurave.”*

## Rrethanat e rastit dhe veprimet e Avokatit të Popullit

5. Avokati i Popullit, në bazë të nenit 16, paragrafi 1, të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, më 24 nëntor 2021 kishte pranuar ankesë nga ankuesi, parashtruar kundër Gjykatës Themelore në Prishtinë, për shkak të zvarritjes procedurale për ta shqyrtuar lëndën C.nr. 2837/17, e cila ka të bëjë me kontest për vërtetim të pronësisë.
6. Sipas dokumentacionit që kemi pranuar nga pala, kuptohet se ai më 24 tetor 2017, në Gjykatën Themelore në Prishtinë kishte parashtruar Padi për vërtetim të pronësisë në bazë të ekzekutimit të kontratës për shitblerjen e paluajtshmërisë, dhe deri në kohën e parashtrimit të ankesës në Institucionin e Avokatit të Popullit (IAP) nuk kishte marrë asnje njoftim lidhur me ecurinë e lëndës.
7. Ankuesi, më 6 korrik dhe më 15 shtator 2020, më 12 janar, më 12 prill, më 12 dhe 19 tetor 2021, i ishte drejtuar GjThP-së me kërkesë për përshtypsim të procedurës, mirëpo nuk kishte marrë përgjigje.
8. Më 12 janar 2022, Avokati i Popullit i ishte drejtuar me shkresë kryetares së GjThP-së, me kërkesë për informata lidhur me ecurinë e lëndës dhe për veprimet e ndërmarra nga ana e gjykatës, në mënyrë që kjo lëndë të procedohej brenda një afati të arsyeshëm kohor.
9. Më 25 janar 2022, Avokati i Popullit përmes një shkrese ishte njoftuar nga ana e kryetares së GjThP-së:

*“Gjyqtari i rastit lëndën C.nr.2837/17 e ka pranuar në punë më 23 shtator 2021 dhe e njëjta ende nuk është proceduar për shkak të numrit të madh të lëndëve të pranuara më herët se lënda në fjala dhe e njëjta nuk hyn në kategorinë e lëndëve me prioritet ligjor dhe i përket kategorisë së lëdëve të rregullta kontestimore që procedohen sipas radhës së*

*vjetërsisë në pajtim me planin dhe Strategjinë e gjykatës për kryerjen e lëndëve të vjetra dhe atyre me prioritet ligjor.”*

10. Më 12 prill 2022, përfaqësuesja e IAP-së ishte njoftuar nga pala se gjykata nuk kishte ndërmarrë ende ndonjë veprim procedural lidhur me lëndën.
11. Më 3 tetor 2022, Avokati i Popullit, përmes shkresës së dytë përcjellë kryetares së GjThP-së, kishte kërkuar informata nëse gjykata kishte arritur të ndërmerrte ndonjë veprim procedural lidhur me çështjen, duke pasur në konsideratë periudhën kohore të kaluar prej 5 vjetësh nga momenti i dorëzimit të padisë në gjykatë.
12. Më 12 tetor 2022, Avokati i Popullit, përmes një shkrese, ndër të tjerash ishte njoftuar nga ana e kryetares së GjThP-së:

*“Gjykata ka ndërmarrë veprime procedurale në drejtim të zgjidhjes së lëndës duke dërguar padinë për përgjigje te pala e paditur dhe pas pranimit të përgjigjes gjykata do ta procedoj lëndën sipas kohës së pranimit të lëndës në gjykatë.”*
13. Më 29 maj 2023 pala ka njoftuar IAP-në se më 10 mars 2023, përmes përfaqësuesit të tij të autorizuar, ka parashtruar në GjThP, Kërkesë për ndërmjetësim në çështjen kontestimore 2837/17. Pala ka konfirmuar se për këtë kërkesë nuk ka marrë përgjigje nga gjykata, deri më tani.
14. Më 6 qershor 2023, përfaqësuesja e IAP-së është njoftuar nga ankuesi se edhe pas paraqitjes në gjykatë të kërkesës për ndërmjetësim, i njëjtë ende nuk ka marrë asnje informatë nga gjykata lidhur me veprimet procedurale të mëtutjeshme rrëth shqyrimit të çështjes. Nga i njëjtë është kuptuar se për çështjen nuk është mbajtur asnje seancë gjyqësore deri më tani.

#### **Instrumentet ligjore të zbatueshme në Republikën e Kosovës**

15. Kushtetuta e Republikës së Kosovës, në nenin 21, paragrafi 2, përcakton:

*“Republika e Kosovës mbron dhe garanton të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, të parashikuara në këtë Kushtetutë.”*
16. E drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm është e drejtë e garantuar me Kushtetutë, e cila në nenin 31, paragrafi 1, përcakton:

*“Cdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.”*
17. Po ashtu mbrojtja gjyqësore e të drejtave, e përcaktuar me nenin 54 të Kushtetutës, parashev:

*“Cdokush gjëzon të drejtën e mbrojtjes gjyqësore në rast të shkeljes ose mohimit të ndonjë të drejte të garantuar me këtë Kushtetutë ose me ligj, si dhe të drejtën në mjete efektive ligjore nëse konstatohet se një e drejtë e tillë është shkelur.”*
18. Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (KEDNj), sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës, është dokument ligjor drejtpërdrejt i zbatueshëm në Republikën e Kosovës dhe ka prioritet, në rast konflikti,

ndaj dispozitave, ligjeve dhe akteve të tjera të institucioneve publike.<sup>1</sup> Ndërsa paragrafi 1 i nenit 6 të KEDNj-së garanton:

*“Në përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve civile, çdo njëri ka të drejtë për një proces të drejtë dhe të hapur brenda një afati të arsyeshëm kohor.”*

19. Po ashtu Ligji nr. 06/L-054 për Gjykatat, neni 7, paragrafi 2, përcakton:

*“Çdo person ka qasje të barabartë në gjykata dhe askujt nuk i mohohet e drejta në gjykim të drejtë në përputhje me procedurën e rregullt ligjore ose të drejtë në mbrojtje të barabartë me ligj. Çdo person fizik apo juridik ka të drejtë në gjykim të drejtë dhe brenda afatit të arsyeshëm kohor.”*

20. Ndërsa neni 7, paragrafi 5, i Ligjit për Gjykatat përcakton:

*“Të gjitha gjykatat duhet të funksionojnë në mënyrë të shpejtë dhe efikase për të siguruar zgjidhjen e shpejtë të lëndëve.”*

### **Analiza ligjore**

21. Avokati i Popullit jua sjell në vëmendje se e drejta për një proces të drejtë dhe brenda një afati të arsyeshëm kohor është e drejtë e garantuar me instrumente ndërkombëtare drejtpërsëdrejti të zbatueshme në Kosovë, me Kushtetutë dhe me ligje përkatëse. Andaj zvarritja e procedurës gjyqësore lidhur me shqyrtimin e kësaj lënde në GjThP paraqet shkelje të së drejtës për një proces të rregullt brenda një afati të arsyeshëm kohor, e garantuar me paragrafin 1 të nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.
22. Sipas nenit 53 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GjEDNj).
23. GjEDNj-ja në disa raste ka theksuar se e drejta e palës që për çështjen e tij të vendoset në afat të arsyeshëm kohor paraqet element qenësor të së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, ashtu siç është e paraparë me nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.
24. Avokati i Popullit jua sjell në vëmendje se praktika gjyqësore e GjEDNj-së ka vërtetuar se zgjatja e procedurës illogaritet nga koha e inicimit të procedurave gjyqësore (shih, në mes të tjerash, aktgjykin: *Moldovan dhe të tjerët kundër Rumanisë*, më 12 korrik 2005, dhe aktgjykin: *Sienkiewicz kundër Polonisë*, më 30 shtator 2003) deri në kohën kur çështja ka përfunduar dhe/ose aktgjyki është ekzekutuar (shih aktgjykin: *Poitier kundër Francës*, më 8 nëntor 2005).
25. GjEDNj-ja në rastin *Kurzac kundër Polonisë*, 22 shkurt 2001, kishte theksuar se arsyeva e kohëzgjatjes së procedurës duhet të vlerësohet nën dritën e rrethanave të veçanta të rastit dhe duke pasur parasysh kriteret e përcaktuara në praktikën gjyqësore të gjykatës, në veçanti kompleksitetin e çështjes, sjelljen e aplikuesit dhe atë të autoriteteve përkatëse, veprimet e gjykatës dhe të autoriteteve përkatëse të përfshira në proces si edhe rëndësinë e çështjes për palën paditëse në procesin gjyqësor.

<sup>1</sup> Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 22.

26. Në rastin *Zimmermann dhe Steiner kundër Zvicerës*, 13 korrik 1983, GjEDNj-ja ka proklamuar faktin e përgjegjësisë së shteteve në organizimin e sistemeve të tyre të drejtësisë, ashtu që gjykatave t'u mundësohet përbushja e kërkeseve të dala nga neni 6 i Konventës, duke përfshirë edhe zhvillimin e procesit gjyqësor brenda një periudhe kohore të arsyeshme. Pra është përgjegjësi e shtetit që ta organizojë sistemin e vet gjyqësor në atë mënyrë që të jetë në gjendje të përballet me raste të pazgjidhura dhe të përsëritura.
27. Lidhur me llogaritjen e kohëzgjatjes së procedurës, GjEDNj-ja, në rastin *Portington kundër Gregisë*, më 23 shtator 1998, ku procedura e apelimit të vendimit kishte zgjatur përreth 8 vjet, kishte theksuar se llogaritja e kohëzgjatjes fillon nga momenti i dorëzimit të ankesës në gjykatë deri në zgjdhjen përfundimtare të çështjes me vendim gjyqësor.
28. Në rastin e ankuesit z. Bajrami, Avokati i Popullit rithekson se periudha përkatëse për t'u shqyrtuar lënda e ankuesit fillon prej datës 24 tetor 2017, datë kjo kur paditësi kishte paraqitur në GjThP Padinë për vërtetim të pronësisë në bazë të ekzekutimit të kontratës mbi shitblerjen e patundshmërisë.
29. Lidhur me rastin në fjalë, Avokati i Popullit vlerëson se ka shkelje të nenit 6 të KEDNj-së dhe të nenit 31 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, në kuptim të së drejtës përgjim brenda një afati të arsyeshëm kohor, duke pasur parasysh se qysh nga dorëzimi i padisë në gjykatë e deri më tanë kanë kaluar rrith 6 vjet dhe çështja ende nuk ka arritur të shqyrtohet.
30. Po ashtu pamundësia e shfrytëzimit të ankesës, si rezultat i mungesës së mjeteve efektive, për shkeljen e së drejtës për një proces të rregullt brenda një kohe të arsyeshme, siç është e garantuar me nenin 6 të KEDNj-së, përbën shkelje të nenit 13 të Konventës, i cili thotë: “*Çdo person, të cilit i kanë shkelur të drejtat dhe liritë e njohura me këtë Konventë, ka të drejtë të paraqesë një ankim efektiv përpëra një instance kombëtare, edhe kur kjo shkelje ka qenë kryer nga persona që veprojnë brenda ushtrimit të tyre zyrtare.*”
31. Për sa i përket zbatimit të nenit 13, Avokati i Popullit jua rikujton se GjEDNj-ja disa herë e ka theksuar se vonesat e mëdha në administrimin e drejtësisë, në rastet kur palët në procedurë nuk kanë mjete efektive për ankim për rastet e zvarritjes së procedurave gjyqësore, përbëjnë kërcënim për sundimin e ligjit brenda rendit ligjor vendor (shih aktgjykimin në rastin *Bottazi kundër Italisë*, më 28 korrik 1999, dhe aktgjykimin në rastin *Di Mauro kundër Italisë*, më 28 korrik 1999).
32. Neni 13 i KEDNj-së pasqyron në mënyrë të drejtpërdrejtë obligimin e shtetit që fillimisht të mbrojë të drejtat e njeriut përmes sistemit të tij ligjor, duke vendosur me këtë rast një garanci shtesë, për një individ, që e bën të mundur që ai apo ajo t'i gëzojë të drejtat në mënyrë efektive. Vështruar nga ky aspekt, e drejta e një individi për proces të rregullt brenda një kohe të arsyeshme do të jetë më pak efikase nëse nuk ekziston mundësia që individi së pari ta parashtrojë këtë ankesë te një autoritet vendor. Kërkuesat e nenit 13 mbështesin kërkuesat e nenit 6 (shih aktgjykimin: *Kudla kundër Polonisë*). Kështu neni 13 garanton një mjet ankimi efektiv në një autoritet vendor për një shkelje të pohuar të kërkeseve të nenit 6 për ta shqyrtuar një rast gjyqësor brenda një kohe të arsyeshme. Pasi rasti në fjalë ka të bëjë me ankesën lidhur me kohëzgjatjen e procedurës, neni 13 i Konventës është i zbatueshëm.

33. Lidhur me kërkesat e nenit 13 të KEDNj-së, Avokati i Popullit jua rikujton se efekti i këtij nenit është ekzistencë e një mjeti ligjor vendor, që merret me substancën e “një ankese të kontestueshme”, sipas Konventës, dhe ta lejojë lehtësimin përkatës (shih p.sh. aktgjykimi në rastin *Kaya kundër Turqisë*, më 19 shkurt 1998). Çfarëdo mjeti i tillë duhet të jetë efektiv si në praktikë ashtu edhe në ligj (shih p.sh. aktgjykimi në rastin *Ilhan kundër Turqisë*, më 27 qershori 2000).
34. Lidhur me ankesën për zvarritje të procedurës, Avokati i Popullit jua rikujton se “mjetet efektive”, në kuptim të nenit 13, do të duhej të kishin qenë në gjendje ta parandalonin shkeljen e pohuar apo mosvazhdimin e saj, ose të ofronin përmirësimin adekuat për çfarëdo shkelje që tashmë kishte ndodhur (shih aktgjykimin e lartpërmendur *Kudla*).
35. Avokati i Popullit vëren se në sistemin tonë të brendshëm nuk ekziston një mekanizëm ligjor, përmes të cilit ankuesi do të kishte mundur të ankohej për zvarritje të procedurës, për të arritur çfarëdo lehtësimi në formë të parandalimit apo të kompensimit.

### **Konstatimet e Avokatit të Popullit**

36. Avokati i Popullit sjell në vëmendje se sipas praktikës gjyqësore të GjEDNj-së, kohëzgjatja e procedurës llogaritet nga koha e inicimit të procedurës gjyqësore, që në rastin konkret është data 24 tetor 2017, dhe konstaton se zvarritja e tillë pa vendim përfundimtar shkel:
- *të drejtën për gjykim të drejtë, proces të rregullt, brenda një afati të arsyeshëm kohor, të përcaktuara dhe të mbrojtura me nenin 31 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe me nenin 6 të KEDNj-së;*
  - *të drejtën për mjete efektive juridike, të mbrojtura me nenin 32 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe me nenin 13 të KEDNj-së;*
  - *të drejtën për mbrojtje gjyqësore të të drejtave të përcaktuara në nenin 54 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.*
37. Duke u bazuar nga të cekurat më lart, Avokati i Popullit, në pajtim me nenin 135, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (“[...] ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa, nëse vëren shkelje të drejtave dhe lirive të njeriut nga ana e organeve të administratës publike dhe organeve të tjera shtetërore.”) dhe me nenin 16, paragrafi 8, të Ligjit për Avokatin e Popullit (“Avokati i Popullit mund të jap rekomandime të përgjithshme për funksionimin e sistemit gjyqësorë. Avokati i Popullit nuk do të ndërhyjë në rastet dhe procedurat tjera ligjore që janë duke u zhvilluar para gjykatave, përvèç rastit kur ka zvarritje të procedurës.”), si dhe bazuar në analizën ligjore të mësipërme, në cilësinë e rekomanduesit, duke iu referuar argumenteve të lartpërmendura, me qëllim të përmirësimit të punës në sistemin gjyqësor të Kosovës, i

### **REKOMANDON**

#### **Gjykatës Themelore në Prishtinë:**

- **Pa vonesa të mëtutjeshme, t'i ndërmarrë të gjitha veprimet përkatëse për shqyrtimin dhe përvendosjen për lëndën Cnr. 2837/17.**

Në pajtim me nenin 132, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (“Çdo organ, institucion ose autoritet tjetër, që ushtron pushtet legitim në Republikën e Kosovës, është i detyruar t'u përgjigjet kërkesave të Avokatit të Popullit dhe t'i paragjë atij/asaj të gjitha

dokumentet dhe informacionet e kërkuar në pajtim me ligj") dhe me nenin 28 të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit ("Autoritetet, të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar rekomandim, kërkesë ose propozim për ndërmarrjen e veprimeve konkrete, (...) duhet të përgjigjen brenda qafatit tridhjetë (30) ditor. Përgjigjja duhet të përbajë arsyet me shkrim për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë"), ju lutemi mirësish të na informoni për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë.

Me nderime,

Naim Qelaj  
Avokat i Popullit

